

V E N D I M
Nr.430, datë 11.6.2001

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.440, DATË 9.9.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË
SË NDËRTIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Kryeministrit Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

1. Pagat e punonjësve të Policisë së Ndërtimit rriten në masën 8 për qind. Tabela nr.2 “Pasqyra e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit në qendër” dhe “Pasqyra e pagave për punonjësit e degëve të Policisë së Ndërtimit në rrethe” zëvendësohen me tabelat me të njëjtin numër, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Niveli më i ulët i pagës për ushtarakët e Policisë së Ndërtimit bëhet 9 148 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (kryetar dege) bëhet 24 176 lekë në muaj.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2001, miratuar për Policinë e Ndërtimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

TABELA NR.2
PASQYRA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË POLICISË SË NDËRTIMIT NË
QENDËR

Nr.	EMËRTIMI	KLASA	PAGA NË LEKË
1.	Drejtor		61 301
2.	Zëvendësdrejtor		43 778
3.	Kryetar dege	XXII	24 176
4.	Shef sektori	XXII	24 176
5.	Kryetar grupi gadishmërie	XXII	24 176
6.	Specialist	XXI	21 771
7.	Shofer	IX	13 930
8.	Punonjës grupi gadishmërie	XIX	19 510
9.	Arkivist, daktilografist, protokollist	VI	12 362
10.	Magazininier	VI	12 362
11.	Sekretare, daktilografiste	VI	12 362
12.	Punonjës shërbimi	III	11 075
13.	Pastruese	I	9 148

PASQYRA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË POLICISË SË NDËRTIMIT NË
RRETHE

Nr.	EMËRTIMI	KLASA	PAGA NË LEKË
1.	Kryetar Dege K1	XXII	24 176
2.	Kryetar Dege K2	XXI	21 771
3.	Shef sektori	XXI	21 771
4.	Specialist i lartë	XX	20 533
5.	Specialist i mesëm	VIII	12 337

6.	Kryetar grupi gadishmërie	XXI	21 771
7.	Specialist grupi gadishmërie	XIX	19 510
8.	Arkiv, protokoll	VI	12 362
9.	Shofer	IX	13 930